

L I G J
Nr.8479, datë 29.4.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8391, DATË 28.10.1998 “PËR SHËRBIMIN
INFORMATIV KOMBËTAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8391, datë 28.10.1998 bëhen këto ndryshime:

“Në nenin 1, fjalët “dispozitat kryesore kushtetuese” zëvendësohen me fjalën “Kushtetutën””.

Neni 2

Në nenin 3 paragrafi i tretë, fjalët “respektimit të të drejtave dhe të lirive të individit” zëvendësohen me fjalët “respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

Neni 3

Në nenin 5 paragrafi 2 bëhen këto ndryshime:

- Fjala “zëvendëskryetar” zëvendësohet me fjalën “zëvendësdrejtor”.

- Në fund të këtij paragrafi shtohet fjalia:

“Punonjësit e tjerë emërohen e shkarkohen nga Drejtori i SHIK-ut.”

Neni 4

Në të gjitha dispozitat e këtij ligji, fjalët “Kryetari i Këshillit të Ministrave” zëvendësohen me fjalën “Kryeministri”.

Në të gjitha dispozitat e këtij ligji, fjala “kryetar” zëvendësohet me fjalën “drejtor”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2356, datë 3.5.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**